

Raport i bujqësisë organike ————— 2022

SHQIPËRI

Raport mbi Statusin
e Bujqësisë dhe
Industrië Organike
në Shqipëri

Gefördert durch



Bundesministerium
für Ernährung
und Landwirtschaft

BÖLN

Bundesprogramm Ökologischer Landbau
und andere Formen nachhaltiger
Landwirtschaft

aufgrund eines Beschlusses des
Deutschen Bundestages

EKOconnect

Botim

Redaktoi

Joachim Lenz,
Claudia Neumann



EkoConnect e.V.
Schützengasse 16
01067 Dresden
www.ekoconnect.org

Autor

Christoph Arndt

Korrigjimi

EkoConnect e.V.

Faqosja dhe radhitja

www.whateverworks.biz

Gefördert durch



Bundesministerium
für Ernährung
und Landwirtschaft

BÖLN

Bundesprogramm Ökologischer Landbau
und andere Formen nachhaltiger
Landwirtschaft

aufgrund eines Beschlusses des
Deutschen Bundestages

Deklarim

Ky raport është financuar nga Ministria Gjermane e Ushqimit dhe Bujqësisë
në kuadër të projektit **28210E001**.

Ky raport është përgatitur me dijeninë dhe besimin tone. Megjithatë, ne nuk mund
të pranojmë asnjë garanci për saktësinë, korrektësinë ose plotësinë e informacionit
dhe të dhënave të ofruara.

Përmbajtja

A Fakte dhe figura	3
B Historia e bujqësisë organike në Shqipëri	7
C Kuadri kombëtar ligjor dhe kontrolli i prodhimit organik	10
D Programi kombëtar i mbështetjes organike	11
E Institucionet dhe aktorët në sektorin organik shqiptar	12
F Kontrolli dhe certifikimi organik sipas rregulloreve të BE-së	14
G Bujqësia organike	16
H Përpunimi organik dhe prodhimi i ushqimit	20
I Eksporti organik	26
J Tregu organik shqiptar	27
Situata dhe trendet në shitjet e ushqimeve organike	
Shitjet e drejtpërdrejta	
Dyqane të specializuara dhe katering	
Tregtia e zakonshme me pakicë e ushqimeve konvencionale	
Importi i produkteve ushqimore	
K Perspektivë	31
L Burimet	32

Fakte dhe figura

Harta




Figura 1: Harta e Shqipërise me 61 bashki

Vendi

28,750 km²

Sipërfaqja

772,000 (Instat)

Numri i familjeve

1.6 Milion

Shqiptarë që banojnë jashtë vendit (shumica në Greqi, e ndjekur prej Italisë)

3.7 Persona

Madhësia mesatare e familjes

22 %

Ndihmesa e bujqësisë në GDP-i

9 %

Ndihmesa e manifakturës në GDP-i

2.9 Milion

Popullsia banuese e zakonshme (2021)

62 %

Popullsia qytetare

4,629 EUR

PBB për banor (vlera e tretë më e ulta në Europë pas Moldovisë dhe Ukrainës)

Lek Shqiptar (ALL)

Monedha (Kursi afro 120 Lek për 1 EURO)

20 %

Ndihmesa e minierave në GDP-i

673 Milion. EURO

Dërgesa në para prej emigrantëve (2020)

702 Milion. EURO

Dërgesa në para prej emigrantëve (2019)

Gjeografia

— Relievi dhe përdorimi i tokës:

Terreni i Shqipërisë është malor: 77 % e territorit është kodrinor dhe malor (lartësia mbidetare mesatare: 708 metra). Pjesa fushore perëndimore e vendit, e cila përbën 21 % të territorit, zë 53% të të gjithë popullsisë së Shqipërisë. Vetëm 20 % e popullsisë jeton në lartësinë mbi 1000 m.

— Toka e punueshme:

22 %, Pemët shumëvjeçare: 3 %, Kullotat dhe pyjet: 46 %. Ullishtet dhe agrumet përbëjnë pjesën më të madhe të kulturave të përhershme. Në Veri, rrëzë Alpeve Shqiptare,

mijëra familje merren me grumbullimin dhe tregtimin e gështenjave. Bimët mjekësore dhe aromatike të cilat luajnë një rol të madh në tregtinë e eksportit mbledhen kryesisht nga kullotat malore.

— Klima:

Mesdhetare në bregdet dhe kontinentale në lartësitë Veriore dhe Lindore. Shqipëria përfiton shumë më tepër rreshje se shumica e vendeve të tjera të Mesdheut: Mesatarisht 1,485 mm, me 750 mm në lartësinë Lindore të Korçës, por deri në 1,700 mm në rajonin bregdetar Veri-Perëndimor të Shkodrës dhe 1,200 mm në rajonin

bregdetar Jugperëndimor të Sarandës. Për të krahasuar: Bari në anën tjetër të detit Adriatik ka vetëm 575 mm shi. Më shumë se gjysma e Shqipërisë gëzon mbi 1100

mm reshje. Ka rreth 130 ditë me shi në vit me 75 % mundësi ndodhje, ndërmjet nëntorit dhe majit. Për të krahasuar: Bari ka vetëm 67 ditë me shi.

Historia

Shqipëria e sotme është rezultat i epokës së diktatorit Enver Hoxha që drejtoi vendin nga viti 1944 pas çlirimit nga pushtimi gjerman deri në vdekjen e tij në 1985, me një izolim pothuajse të plotë ndërkombëtar të vendit në vitet 1970 dhe 1980, një parti komuniste, që sundoi deri në vitin 1992 dhe përmbysja e plotë e sistemit me institucionet, vlerat dhe normat e tij në vitet 1990 pas largimit të partisë komuniste. Kjo çoi në anarki, korrupsion dhe zhvillimin e krimit të organizuar në dekadën e parë të demokracisë. Ndërsa shumica e vendeve ish-sovjetike ruanin rregullat, rregulloret dhe shërbimet e vendosura gjatë komunizmit, në Shqipërinë postkomuniste, nuk kishte shumë trashëgimi nga ish-institucionet publike. Migrimi i fortë veçanërisht në Greqi dhe Itali, por edhe në Shtetet e Bashkuara, ishte pasojë e

rënies ekonomike dhe paqëndrueshmërisë politike. Vetëm në vitet 2000, shteti i së drejtës u konsolidua në Shqipëri. Në vitin 2008, Shqipëria u ftua të anëtarësohej në NATO (anëtarësimi i plotë në 2014).

Anëtarësimi në BE: Shqipëria aplikoi për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, duke u bërë një kandidat zyrtar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në qershor 2014. Bisedimet e anëtarësimit filluan në mars 2020. Deri në vitin 2020, Shqipëria kishte marrë 1.2 miliardë euro ndihmë zhvillimore nga Asistenca e Para-Aderimit (IPARD), një mekanizëm financimi për vendet candidate për në BE. Qasja pa taksa në tregun e BE-së u jepet produkteve nga Shqipëria që prej vitit 2000. Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi udhëtimin pa viza në zonën Shengen për qytetarët shqiptarë në vitin 2010.

Tregtia

Marrëveshjet e tregtisë së lirë: Që nga viti 2016, Shqipëria ka zbatuar tarifa preferenciale për produktet me origjinë nga vendet anëtare të BE-së, CEFTA (Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia), EFTA (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra), dhe Turqisë. Sipas marrëveshjes me BE-në, të gjitha produktet bujqësore me origjinë nga Shqipëria mund të hyjnë në BE pa taksa, me përjashtim të mishit të viçit, sheqerit dhe verës, të cilat janë subjekt i tarifave preferenciale të importit në BE. Sa i përket eksporteve të BE-së në Shqipëri, disa produkte nuk janë liberalizuar plotësisht, kryesisht mishi, produktet e qumështit si qumështi, kremi, gjalpi, djathi feta, vezët, mjalti, frutat dhe perimet e freskëta dhe të përpunuara që prodhohen zakonisht në Shqipëri, mielli i grurit dhe verë (10–15 % tarifë). Makineritë dhe pajisjet përgjithësisht i nënshtrohen detyrimeve doganore 0 %.

Fortesa ekonomike të Shqipërisë janë minierat dhe industria e rëndë (çeliku, alumini, kromi, çimento)

dhe energjia (nafta dhe hidrocentralet). Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës në Shqipërinë jug-qëndrore, e cila filloi prodhimin në vitin 1930, është fusha më e madhe e naftës në tokë në Evropë dhe aktualisht është ende në shfrytëzim. Prodhimi i veshjeve tekstile dhe i këpucëve ka vetëm vlerë shtesë relativisht të ulët. Fabrikat e fasonit, të tekstilit dhe të këpucëve punojnë pothuajse tërësisht për markat italiane dhe pothuajse nuk ka ndonjë markë shqiptare në treg. Në sektorin agrorshqimor, peshku po luan një rol prijës. Gati një e treta e të gjitha eksporteve në sektorin agrorshqimor vjen nga peshku i freskët dhe i përpunuar (105 milionë euro në 2020). Pika të tjera të forta janë perimet e freskëta, (79 milionë euro në 2020) bimët mjekësore dhe aromatike si dhe vajrat esenciale (50 milionë euro në 2020). Shqipëria ka një përparësi konkurruese për perimet (domate, spec, trangull) jashtë stine (kryesisht të hershme) duke përfshirë edhe pjeprin. Bimët mjekësore dhe aromatike janë kryesisht nga vjelja në natyrë dhe grumbullimi në zonat malore.

Tregtia agro-ushqimore: BE ka një tepricë të madhe të bilancit tregtar të agro-ushqimeve me Shqipërinë, i përbërë kryesisht nga mielli, makaronat dhe produkte të tjera të drithërave (gruri, misri elbi, etj), produkte qumështi, pije jo-alkoolike, ëmbëlsira dhe kafshë të gjalla për therje. Në krahun tjetër, BE importon kryesisht perime të freskëta si dhe peshk të freskët dhe të përpunuar.

Tregu ushqimor: Anketa e Buxhetit Shqiptar të Familjeve 2020 (Instat Albania) tregon se 42 % e shpenzimeve mesatare të konsumit të një familjeje

vendase shpenzohen për ushqime dhe pije joalkoolike (rreth 0.97 milionë lekë mesatarisht, 8200 euro). Kjo është vlerë e lartë në krahasim me BE-në ku shifra është në 11 %. Në Tiranë shpenzohen rreth 1.18 milionë lekë për ushqim për familje (rreth 9800 euro). Kjo është më e lartë për person sesa në Gjermani. Tregu ushqimor vlerësohet në mbi 6 miliardë euro. Rrjetet e supermarketeve Big Market, Spar, Conad, Ecomarket kapin vetëm rreth 10 % të të gjithë tregut ushqimor në vend. Ushqimi shitet kryesisht në dyqane të vogla.

Pikat e forta të ekonomisë shqiptare (2020)




Figura 2: Vlera e eksporteve nga Shqipëria

Eksportet agro-ushqimore (2020)




Figura 3: Vlera e eksporteve të bujqësisë dhe ushqimeve prej Shqipërisë

Historia e Bujqësisë Organike në Shqipëri

Bujqësia organike e certifikuar filloi vetëm në vitin 1999, por sot, më shumë se dhjetë vjet pasi projekti SASA përfundoi, nuk ka asnjë shoqatë organike aktive që përfaqëson prodhuesit organik të Shqipërisë. Historia e suksesit në sektorin organik të Shqipërisë ka qënë kontrolli lokal i organit Albinspekt i cili u themelua në vitin 2006.

Nëse bujqësia organike do të përkufizohet prej veprimtarive organike të certifikuara, atëherë bujqësia organike në vend ka pak histori dhe ende nuk është plotësisht e konsoliduar. Numri i operatorëve organikë, i sipërfaqes së mbjellë si dhe i sipërfaqes së vjeljes/grumbullimit në natyrën e egër luhaten mjaft nga viti në vit.

Prodhuesi i parë i certifikuar si organik në vend ishte **Arben Islami** (atëkohë Aris-Frucht, sot Elite AE) që u certifikua në vitin 1999, pas 6 vitesh të eksportit të bimëve, erëza të freskëta konvencionale në Zvicër. Kjo familje pioniere ka fermën e saj ende aktive në vitin 2022 me eksporte të rregullta të një larmie llojesh erëzash të freskëta drejt partnerëve tregtarë zviceranë të saj.

Ngjitja e bujqësisë organike të certifikuar është e ndërlidhur fort me **Projektin SASA** të financuar nga Zvicra (Mbështetje e qëndrueshme bujqësore në Shqipëri, 2001–2011) i cili u zbatua nga FiBL. Suksesi i parë i saj ishte certifikimi organik i prodhuesit të vajit të ullirit **Shpresa Shkalla** në vitin 2001, vaji i së cilës është tregtuar nga kompania zvicerane **Claro Fair Trade**, që nga viti 2004 e deri më sot. Kjo u pasua në vijim me certifikimin organik të disa eksportuesve të bimëve mjekësore dhe aromatike nga grumbullimi në natyrën e virgjër.

Nxitja e parë në certifikimin organik erdhi në vitin 2006 me themelimin e trupës së kontrollit **Albinspekt**, e

cila fillimisht operoi si një OJQ e financuar nga projekti SASA dhe që nga viti 2011 si një kompani e suksesshme, derisa u ble nga **Bio.inspecta AG** në 2019. Si degë e bio.inspecta, ajo vazhdon të funksionojë si “Albinspekt” në Shqipëri dhe sot ka një pjesë tregu mbi 90 %. Albinspekt mori akreditimin e DAkkS në vitin 2007 dhe është i vetmi organ kontrollues i njohur nga Qeveria e Shqipërisë për inspektimin e fermave organike të certifikuara sipas standardit organik shqiptar (Ligji 9199 / 2004, i përafuar nga Ligji 106 / 2016). Ky certifikim, kundrejt standardit organik shqiptar është parakusht për marrjen e subvencioneve organike, dhe për këtë arsye Albinspekt ka qënë instrument në mbajtjen e një numri fermash të vogla familjare të certifikuara organike.

Rritja e dytë në certifikimin organik erdhi në vitin 2010 kur **pagesa e subvencionimit** për fermat organike që prodhojnë për tregun vendas u rrit në 375 EUR (dhe 500 EUR në 2011) nga një fraksion i asaj që u fut në vitin 2008. Kur fermerët organikë duhej të kuptonin se ishte e vështirë mundësia për të shitur prodhimet e tyre brenda vendit me një çmim premium, shifrat ranë sërish. Megjithatë, tendenca e përgjithshme është ende në rritje, si pasojë e hapjes së dyqaneve të specializuara në Tiranë, rritjes së turizmit rural si dhe rritjes së kapacitetit për të shfrytëzuar kërkesën për produkte shumë të veçanta eksporti të Shqipërisë, si bimët mjekësore dhe kulinare, gështenja dhe vaj ulliri.

Duke qënë se **eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike është shtytësi i zhvillimit të sektorit organik** në Shqipëri, i cili gjëron më shumë të ardhura, rritja e zonës së certifikuar për grumbullimin e egër tregon më mirë përparimin e bujqësisë organike në vend. Shifra e parë në dispozicion është e vitit 2004 (708 ha). Sot rreth 650,000 ha janë të certifikuar organike për grumbullimin e egër.

Evolucioni i numrit të operatorëve të certifikuar organikë në Shqipëri (2006–2020)




Figura 4: Të dhënat para 2006 ngatërrojnë prodhimin e certifikuar me atë jo- të certifikuar, të dhënat nga viti 2006–2010 prej projektit SASA, të dhënat 2010–2019 prej Botës Së Bujqësisë Organike, ato të vitit 2020 kërkim i vet autorit)

Rritja e sipërfaqes organike të certifikuar për grumbullimin në natyrën e egër (2006–2019 / 1000 ha)




Figura 5: Të dhënat nga 2006–2010 prej projektit SASA, nga 2010–2019 prej Botës së Bujqësisë Organike

Historia e institucioneve të bujqësisë organike nisi në vitin 1997 kur disa persona të lidhur me Universitetin Bujqësor të Tiranës formuan **Shoqatën e Bujqësisë Organike** (OAA). Qëllimi kryesor nuk ishte të përfaqësonte prodhuesit organikë të certifikuar, por më tepër të mbështeste iniciativa të ndryshme të orientuara drejt bujqësisë së qëndrueshme dhe riqarkullimit.

Si ferma organike Uka e themeluar në vitin 1996 nga entomologu dhe ish-ministri i Bujqësisë Rexhep Uka, i cili ka zhvilluar një sistem permakulture 2.5 ha në Laknas afër Tiranës me shumë lloje të rralla dhe një sistem të

sofistikuar mulçërimi – dhe me të gjitha produktet e shërbyera në restorantin e tij, si të prodhuara në fermë dhe në vend. Deri më sot, **Uka Farm**, një pionier në ruajtjen e tokës dhe kontrollin biologjik të dëmtuesve, nuk ka qënë i certifikuar organikisht.

Projekte të ndryshme të financuara nga donatorë përdorën OAA-në për të zbatuar projekte për promovimin e bujqësisë organike, më i rëndësishmi Projekti SASA i financuar nga Zvicra që nga viti 2001. Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për të sjellë bujqësinë organike në axhendën e qeverisë që çoi në Ligjin për Prodhimin, Përpunimin, Certifikimin dhe Tregtimin e produkteve organike (**Ligji 9199 i nxjerrë në 2004**). Ligji bazohej në Rregulloren e BE-së 2091 / 92. Që atëherë, termi "bio" është mbrojtur ligjërisht. Në nenin 9, ligji kërkon përdorimin e termit "bio" për të treguar organin e kontrollit. Ndërsa në vende të tjera mbrojtja e termit "bio" ka qënë pika kthesë në zhvillimin e bujqësisë organike, deri më sot "bio" përdoret lirisht në Shqipëri nga çdo prodhues apo tregtar që pretendon cilësi superiore. Si pasojë, ligji mund të ketë përmbushur kërkesat e BE-së për përaftrim dhe ka hedhur themelet për pagesat e subvencioneve nga viti 2008. Megjithatë, as ligji 9199 / 2004 dhe as ligji 106 / 2016, i cili zëvendësoi ligjin e mëparshëm dhe bazohej në Rregulloren 834 të BE-së. / 2007, nuk ndihmoi plotësisht në zhvillimin e një tregu organik.

Për t'i shërbyer eksportuesve të bimëve mjekësore dhe aromatike, organizatat e para **evropiane të certifikimit organik** filluan aktivitetin e tyre në Shqipëri në gjysmën e parë të viteve 2000. Ndër përpunuesit dhe eksportuesit e mëdhenj të bimëve mjekësore dhe aromatike, Mucaj, Xherdo, Filipi, Elba-Shehu dhe Herba Fruktus kishin marrë certifikimin organik në dekadën e parë të viteve 2000. Dy prej tyre (Elba-Shehu dhe Herba Fruktus) nuk kanë vazhduar certifikimin organik deri më sot. Në gjysmën e parë të viteve 2000, edhe vajrat e ullirit morën certifikimin e parë organik. Në vitin 2006, u krijua një kompani e përpunimit dhe eksportit organik të gështenjës e quajtur AMLA.

Informacion

Uka Farm

<https://www.facebook.com/ukafarm/>

Me synimin për të krijuar një shoqatë të industrisë, Projekti SASA themeloi shoqatën **Bio Adria** në vitin 2005. Bio Adria gjithashtu supozohej të bëhej partneri zbatues për SASA dhe projekte të tjera të financuara nga donatorët. Megjithëse kishte mbi 100 anëtarë deri në vitin 2010, Bio Adria kishte në të vërtetë vetëm një funksion të zbatimit të projektit dhe nuk mund të gjeneronte asnjë prurje tjetër të ardhurash, të pavarur nga projekti në



Figura 6: Enver Isufi duke këshilluar një fermer ulliri

mënyrë që organizata të mos shpërbëhej, sic ndodhi ngadalë pas përfundimit të SASA. Deri më sot, ajo nuk është zëvendësuar nga asnjë shoqatë tjetër legjitime e vërtetë e ndërtuar nga poshtë lart e sipërmarrësve organikë.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në panairin e posacëm, Biofach (Gjermani) deri më sot nuk është organizuar nga shoqata organike të vendit, por nga projekte donatorësh, si SIPPO zvicerane. Shqipëria ka një stendë në Biofach në Nuremberg që nga viti 2007 dhe SIPPO e ka mbështetur atë që nga viti 2012. Kompanitë që ekspozojnë sot produkte në Biofach janë paraqitur në Kapitullin H.

Dy krijime të tjera të projektit të SASA-s, **Shoqata Shqiptare e Marketingut (AAM)** në Tiranë dhe **Instituti i Bujqësisë Organike (IOM)** në Durrës, gjithashtu nuk kanë arritur të fitojnë paratë e tyre duke u shërbyer sipërmarrjeve organike në Shqipëri. AAM u themelua në vitin 2010 për të ndihmuar në krijimin e një tregu organik. Deri më sot ajo mbijeton vetëm me fondet e donatorëve. Për shkak të mungesës së një shoqate të mirëfilltë organike, disa donatorë si SECO dhe SIPPO ende përdorin AAM për të zbatuar projektet e tyre të zhvillimit organik.

IOM u formua në vitin 2009 nga stafi teknik i SASA-s për të ofruar kërkime dhe shtrirje organike në fermë. Mirëpo, asnjëherë nuk është ofruar mbështetje financiare nga Ministria e Bujqësisë siç ishte planifikuar, dhe sot Instituti i Bujqësisë Organike përbëhet vetëm nga drejtori i tij Dr. Enver Isufi.



Figura 7: Pemishte ulliri në luginën e Vjosës

Kuadri kombëtar ligjor dhe kontrolli i prodhimit organik

Ligji organik 106/2016 dhe rregullat përkatëse zbatuese përmbajnë gjithcka që pritet. Megjithatë, mbrojtja e termit “bio” nuk është zbatuar deri më sot.

Që nga viti 2016, Shqipëria ka ligjin e saj organik kombëtar (Nr. 106 / 2016) i cili bazohet në Rregulloren e BE-së 834 / 2007. Ai përcakton rregullat e përgjithshme për prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore organike, ushqimit dhe është plotësuar me një sërë rregullash të mëtejshme zbatuese. Të gjitha këto dokumente janë të disponueshme në faqen e internetit të **Ministrisë së Bujqësisë kushtuar bujqësisë organike** (↪).

Autoriteti kompetent për prodhimin dhe përpunimin organik është Ministri i Bujqësisë, i cili i ka deleguar detyrat Komisionit Kombëtar të Prodhimit Organik (KSHPO) i cili është me zyrë brenda Ministrisë. Ai përbëhet nga anëtarë të Ministrisë së Bujqësisë, ministrive të tjera dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ai miraton organet e kontrollit që funksionojnë sipas ligjit 106 / 2016 dhe regjistron inspektorët organikë.

Albinspekt është i vetmi organ kontrollues i miratuar për të kryer inspektime dhe çertifikime sipas ligjit 106 / 2016. Gjithashtu Albinspekt ka rolin, që të publikojë Listën Pozitive të Inputeve dhe Farave për Prodhimin Organik të përditësuar çdo vit në faqen e saj të internetit. Siç u tha më herët, termi “bio” mbrohet ligjërisht. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur ndonjë

zbatim të kësaj mbrojtjeje. Në vitin 2019 është krijuar edhe një logo e bukur shqiptare, por nuk mund të gjendet në asnjë produkt. Është krejtësisht e panjohur për publikun dhe nuk janë shpenzuar para për të informuar konsumatorët për logon dhe çfarë përfaqëson ajo. Prandaj, prodhuesit organikë të certifikuar që prodhojnë produkte ushqimore organike për tregun vendas përdorin me mençuri logon e gjelbër organike të BE-së.



Figura 8: Logoja kombëtare organike nuk mund të gjendet në asnjë produkt

Programi kombëtar i mbështetjes organike

Dy masa të Skemës Kombëtare të Mbështetjes së Bujqësisë kanë ndihmuar në zgjerimin e bujqësisë organike: Një subvencion i paguar për fermë për të kompensuar çdo humbje të të ardhurave gjatë konvertimit dhe një subvencion për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike që paguhet për hektar.

Edhe pse Strategjia e fundit Kombëtare e prodhimeve organike ka skaduar në vitin 2013, ekzistojnë disa masa për të dhënë mbështetje nga qeveria për prodhuesit organikë: Nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes Bujqësore dhe Granteve IPARD.

Shumë prodhues organikë mund të përfitojnë nga dy masa të Skemës Kombëtare të Mbështetjes Bujqësore. **Masa 5** i kushtohet mbështetjes për fermat organike, të inspektuar sipas Ligjit 106 / 2016 (d.m.th. të inspektuar nga Albinspekt), morën për vitin 2021:

- 100 000 ALL në vitin e parë të kthimit
- 150 000 ALL në vitin e dytë të kthimit
- 200 000 ALL në vitin e parë të kthimit plotësisht të certifikuar

Lista e vitit 2021 e Agjencisë së Pagesave të Subvencioneve/AZhBR e Ministrisë së Bujqësisë

numëronte 102 prodhues të vegjël që përfitonin nga kjo masë. Ata kanë një madhësi mesatare të fermës prej vetëm 2 ha (204 ha në total). Gjithashtu, përfituan 20 kompani që certifikuan tokën për grumbullimin në natyrën e egër (224,000 ha). Në total, shteti ka paguar 148,000 Euro për këtë masë.

Madje një masë tjetër pati më shumë ndikim në bujqësinë organike: Masa 4 për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Në vitin 2021 janë dhënë 200 000 lekë për ha (por jo më shumë se 1 000 000 lekë për fermë individuale). Sipërfaqja minimale e mbjelljes ishte 0.2 ha.

Instrumenti i financuar nga BE për Asistencën e Para-Aderimit në Zhvillimin Rural (IPARD) po jep grante më të mëdha për sipërmarrësit për t'i ndihmuar ata me investimet e nevojshme. IPARD ka një masë për “agromjedisin, klimën dhe bujqësinë organike” e cila pritet të fillojë të funksionojë në vitin 2023. Për këtë masë janë caktuar 1.7 milionë Euro.

Institucionet në sektorin organik shqiptar

Mungesa e një shoqate organike legjitime, kombëtare dhe unanimisht të njohur është një dobësi e madhe për zhvillimin e sektorit organik. Institucionet e drejtuara nga donatorët në përgjithësi nuk kanë qënë në gjendje të mbështesin bujqësinë organike në mënyrë efektive.

Aktorët individualë në prodhim, përpunim, eksport, import dhe shitje me pakicë janë paraqitur në kapitujt G,H,J. Deri më tani, Shqipëria nuk ka një shoqatë organike legjitime, kombëtare dhe të njohur unanimisht që përfaqëson sipërmarrësit e saj organikë. Pas 15 vitesh ekspozitë në **Biofach**, stendat e vendit në Shqipëri ende nuk janë organizuar nga një shoqatë sektori. Kjo është një dobësi e madhe për zhvillimin e sektorit organik.

Projektet e donatorëve e kanë njohur këtë dhe disa herë janë përpjekur të ndërtojnë struktura të tilla si **BioAdria** e cila kishte mbi 100 “anëtarë” në vitin 2010, por u shpërbë ngadalë pas përfundimit të Projektit SASA pasi kishte vetëm funksione të zbatimit të projektit. BioAdria u menaxhua nga stafi i projektit që fillimisht punonte për projektin, i cili u largua kur financimi përfundoi. Një shoqatë e mirëfilltë do të shfaqet vetëm nëse ndërtohet nga brenda komunitetit të sipërmarrësve organikë të certifikuar në një proces nga poshtë-lart me kontribute të mëdha vullnetare në fazën fillestare dhe

kontrolle dhe balanca të vendosura për të shmangur që shoqata të tërhiqet prej interesave individuale të kompanive. Një nismë e tillë nga sipërmarrësit organikë aktualisht nuk po vërehet.

Gjendja, që kemi aktualisht në Shqipëri janë dy shoqata konkurruese të industrisë së bimëve mjekësore dhe aromatike, të cilat përfshijnë eksportuesit kryesorë organikë, por nuk janë të fokusuar në zhvillimin e sektorit organik. Kompanitë përreth **AlbKalustyan** janë anëtarë të **Shoqatës së Prodhuesve dhe Kultivuesve të Esencave (EPCA)** dhe ato rreth **Filipit** zgjodhën të ishin pjesë e **Shoqatës së Mbledhësve, Përpunuesve dhe Eksportuesve të Bimëve Mjekësore (ACPMP)**, në shqip e quajtur ndryshe edhe **IBMA**). Këto shoqata janë ndërtuar më shumë për integrim vertikal në zinxhirët e vlerave sesa për bashkëpunim horizontal. Eksportues të tjerë të rëndësishëm të bimëve mjekësore dhe aromatike organike nuk i përkasin asnjërës prej këtyre shoqatave.

Institucionet që janë ngritur nga Projekti SASA për të mbështetur bujqësinë organike, vështirë se mund t'i përmbushin këto funksione për shkak të mungesës së financimit nga qeveria dhe mungesës së modeleve të biznesit. **Instituti i Bujqësisë Organike në Durrës** (IOM në anglisht dhe IBB në shqip) i krijuar në vitin 2009 sot përbëhet vetëm nga Drejtori i tij Dr. Enver Isufi. **Shoqata Shqiptare e Marketingut** e krijuar në vitin 2010 sot është një mjet për zbatimin e projekteve të zhvillimit organik.

Shoqata e Bujqësisë Organike, e themeluar në vitin 1997 nga intelektualë shqiptarë, është fokusuar më shumë në mbrojtjen e natyrës dhe që prej vitit 2017 është përfshirë në fushatën kundër ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin Vjosa. Një shoqatë konsumatore ose një grup veprimi që zbaton veprimtari për të promovuar konsumin e ushqimit organik nuk është e dukshme.

Sot, prodhuesit organikë mbështeten kryesisht nga konsulentë shqiptarë individualë, të cilët kanë grumbulluar njohuri dhe përvojë që nga fillimi i viteve 1990. Përveç kësaj, ofrues të përzgjedhur të inputeve të tregëtueshme kanë filluar të ofrojnë këshilla dhe të shesin agro-inpute organike. Katër kompani ndërkombëtare që shesin produkte për kontrollin biologjik të dëmtuesve janë të pranishme në tregun e Shqipërisë: **Bio Best** (Belgjikë), **AgroBio** (Spanjë), **Koppert** (Holandë), **BASF** (Gjermani) dhe **ADAMA** (Izrael).

Informacion

Instituti i Bujqësisë Organike në Shqipëri

<https://ibb.al/>

Shoqata shqiptare e Marketingut

<https://aam.al/>

Bio Best

<https://www.biobestgroup.com/>

AgroBio

<https://www.agrobio.es/>

Koppert

<https://www.koppert.com/>

BASF

<https://www.agrar.basf.de/>

ADAMA

<https://www.adama.com/>

Kontrolli dhe certifikimi organik sipas rregulloreve të BE-së

Me mbi 90 % të tregut, Albinspekt dominon kontrollin dhe certifikimin. Ecocert renditet në vendin e dytë.

Albinspekt, i krijuar në vitin 2006, ka qenë një histori e vërtetë suksesi. Organi i kontrollit i cili u ble nga **bio.inspecta AG** (Zvicër) në vitin 2019 ka tashmë mbi 90 % të tregut dhe është i vetmi organ kontrolli i njohur për certifikimin e kompanive në përputhje me ligjin organik shqiptar.

Një numër organesh kontrolli janë autorizuar nga Komisioni i BE-së me qëllim të certifikimit të ekuivalencës sipas Aneksit IV të Rregullores së BE-së 1235/2008; megjithatë, vetëm disa kanë aktualisht klientë në Shqipëri.

Nga 76 kompanitë e mësipërme të certifikuara sipas Rregullores së BE-së, 22 aktualisht kanë një certifikatë të vlefshme sipas Prodhimit Organik Kombëtar (NOP) të SHBA-së dhe 5 janë të certifikuara nga BioSuisse. Asnjë prodhues nuk është i certifikuar nga Demeter ose Naturland.

Si një kompani bijë dhe përfaqësuese e bio.inspecta, Albinspekt së fundmi u akreditua nga Shërbimi Zviceran i Akreditimit (SAS) për të ofruar inspektim dhe certifikim sipas standardit organik bio.inspecta ekuivalent me Rregulloren e BE-së 834 / 2007 (biOS). Nga viti 2022, Albinspekt do të funksionojë vetëm sipas biOS dhe tashmë në vitin 2021, të gjithë operatorët kanë pasur inspektime sipas biOS.

Etiketa e gjelbër organike e BE-së (me AL-BIO-139) gjendet në pesë produkte shqiptare që shiten

në tregun vendas: **çajrat Flora dhe Kraco**, vajrat e ullirit **Musai** dhe **Shkalla** si dhe vezët e Rea's. Megjithatë, ai është keqpërdorur në ambalazhet e firmës shqiptare importuese dhe paketuese të ushqimeve **Neranxi** e cila ka tre dyqane në Tiranë dhe gjithashtu ka produktet e saj në supermarketet Spar dhe Big. Kjo përbën një shkelje të rregullores ndërkombëtare. (↪)



Figura 9: Logoja organike e BE-së

Informacion

Albinspekt

<http://albinspekt.com/>



Trupa kontrollit aktive në Shqipëri për të certifikuar në përputhje me Rregulloren e BE-së

Trupa të kontrollit	Vendi	Kodi mbi produkte	Numri i klientëve me një certifikatë të vlefshme deri në 31.12.2021
Albinspekt / bio.inspecta	Zvicër	AL-BIO-139 (Albinspekt) AL-BIO-161 (bio.inspecta)	61*
Ecocert	Francë	AL-BIO-154	8
Ceres	Gjermani	AL-BIO-140	3
A-Cert	Greqi	AL-BIO-171	1
CCPB	Itali	AL-BIO-102	1
Kiwa / BCS	Gjermani	AL-BIO-141	1
Bioagricert	Itali	AL-BIO-132	1

Figura 10: * Plus 66 klientë të tjerë të certifikuar vetëm në përputhje me Ligjin Organik Shqiptar.



Figura 11: Keqperdorimi i etiketes se BE-se nga Neranxi

Bujqësia organike

Bimët mjekësore dhe aromatike organike janë fortësia e Shqipërisë. Ato mbizotërojnë ndaj sipërfaqes së vogël të Shqipërisë prej vetëm 700 ha tokë bujqësore organike. Në grumbullimin organike të egër (rreth 650,000 ha), Shqipëria është e treta në Europë.

Shqipëria është e dobët në kultivimin organik; dhe blegtoria organike pothuajse nuk ekziston. Më pak se 700 ha tokë bujqësore është e certifikuar organike që është 0.1 % e sipërfaqes së kultivuar. Megjithatë, Shqipëria është e fortë për sa i përket sipërfaqes së grumbullimit organik të certifikuar në natyrë të egër: rreth 650,000 ha, që e vendos Shqipërinë në vendin e tretë në Evropë pas Finlandës dhe Rumanisë.

Grupi më i rëndësishëm i produkteve nga **grumbullimi i egër** janë bimët mjekësore dhe aromatike. Më pas vijojnë gështenjat, boronicat, mollët e egra, kokrrat e dëllinjës, thanat, kokrrat e trëndafilin dhe kërpudhat. Analiza e zinxhirit të vlerave të bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri (2015) vërtetoi se 20,000 familje janë të angazhuara në vjeljen e bimëve dhe frutave të egra. Studimi i FAO-s mbi gështenjat (2010) zbuloi se 3000 familje janë të përfshira në mbledhjen e egër dhe të certifikuar, kryesisht organike të gështenjave.

Mbledhja e bimëve të egra dominohet qartë nga sherebela, por ka një sërë bimësh të tjera të cilat mbledhen me certifikatë organike (shiko figurën 12).

Kompanitë përpunuese dhe eksportuese që janë prezantuar në kapitullin H (operatorët organikë të kategorive 3 dhe 4, shih më shiko figurën 14) paguajnë për certifikimin organik të zonave të grumbullimit të egër. Përveç kësaj, ata/ose kompanitë vendore grumbulluese

do të duhet të blejnë licenca vjetore nga komunat për të qenë në gjendje të blejnë produkte nga grumbullimi i egër në zona të përcaktuara. Megjithatë, kompanitë vendase të grumbullimit jo gjithmonë ia shesin kompanisë që ka paguar për certifikim, por ndonjëherë fermerët vjelës ua shesin grumbulluesëve të palicensuar.

Bimët e mbledhura më shumë me certifikatë organike

Salvia officinalis	Sherebela
Origanum vulgare	Rigoni
Thymus serpyllum	Zhumbrica
Saturea hortensis	Trumza
Rosmarinus officinalis	Rozmarina
Laurus nobilis	Dafina
Sideritis clandestina, syriaca	Caji i malit
Rubus ideus, fruticosus	Mjedra dhe manaferra
Tillia cordata, tomentosa	Lulet e blirit
Crataegus monogyna	Murrizi
Hypericum perforatum	Lule Basani
Urtica dioica	Hidhra

Figura 12: Sasitë e eksportuara në shumëfish të 1000 ton, Sasitë e eksportuara në shumëfish të 100 ton, Sasitë e eksportuara me luhatje nga viti në vit

Për sa i përket tokës me **kultivim kultura organike**, këtu mbizotërojnë bimët mjekësore dhe aromatike. Gjithashtu, rreth 50 ha janë ullishte të vjetra organike. Një shembull është plantacioni i ullirit të zonjës Luljeta Tabaku. Të gjitha kulturat e tjera drufutore (si shumëvjecare e të përhershme) janë të parëndësishme.

Operatorët organike në Shqipëri mund të grupohen në 4 kategori (shiko figurën 14).

Operatorët organikë të Kategorive 2–4 do të raportohen si nën përpunim organik (Kapitulli H).

Për **Kategorinë 1**, Albinspekt raporton listën me 117 prodhues deri në fund të vitit 2021.

Ato përbëhen kryesisht nga fermerë organikë që **kultivojnë bimë mjekësore dhe aromatike** (kryesisht sherebelë, livando, trumzë, rigon, rozmarina, çaj mali, mërsina, dafina dhe petale të ndryshme lulësh, sipas kësaj radhe). Kultivimi i bimëve medicinale dhe aromatike është një prirje e afro dhjetë vjetëve të fundit, që kur oferta e bimëve të caktuara nga grumbullimi i egër po zvogëlohet si pasojë e teknikave jo të duhura të vjeljes dhe kohës së vjeljes së përdorur nga vjelësit, të cilët ndonjëherë nxiten nga blerësit jo të licensuar për të korrur sa më shumë, aq sa të jetë e mundur. Kjo jo vetëm që ndikon në cilësinë e bimëve të egra, por gjithashtu shkakton dëme në popullatat e egra. 40 bimë të egra mjekësore dhe aromatike janë përfshirë tashmë në Librin e Kuq Kombëtar (Prof. Alban Ibrahimi, 2020). Bimët nga kultivimi zakonisht kanë një standard më uniform të cilin tregu e vlerëson. Megjithatë, përmbajtja e tyre e fitokimikateve të dëshiruara është shpesh më e ulët se sa tek barishtet nga grumbullimi i egër. Ndër prodhuesit organikë në Kategorinë 1 është edhe një fidanishte (Salvia Nord) e cila prodhon fidanë organikë të sherebelës, livandës, trumzës dhe rozmarinës.



Figura 13: Bimë organike shqiptare

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së bimëve mjekësore dhe aromatike organike të kultivuara dhe të certifikuara i nënshtrohet bujqësisë me kontratë midis prodhuesve vendas dhe eksportuesve të mëdhenj të bimëve mjekësore dhe aromatike, të cilët do të paraqiten në Kapitullin H. Këto ferma ndodhen kryesisht në rajonin e Shkodrës.

Të dytat për nga rëndësia janë **ullishtet** (rreth 50 ha gjithsej) që përbëhen nga pemë shpesh shumë të vjetra, më shumë se 100 vjeçare dhe që rriten pa ujitje në toka të pjerrëta ku kanë funksione të rëndësishme të kontrollit të gërryerjes (erozionit). Uka Farm ka në tokën e saj një pemë ulliri që është më shumë se 2000 vjet i vjetër. Ndër nëntë varietetet më të kultivuara të ullirit, tetë janë vendase të Shqipërisë. Më interesantja për vajin e ullirit ekstra të virgjër të vlerësuar me çmime është “Kalinjoti” (ullinjtë të gjelbër të celur) i cili mbulon rreth 40 % të sipërfaqes së përgjithshme të ullishteve për përdorim vaji dhe tavoline.

Katër kategoritë e operatorëve organikë

1	Prodhuesit e vegjël , të gjithë të certifikuar nga Albinspekt ose vetëm sipas Ligjit Shqiptar 106/2016 ose, përveç ligjit shqiptar, të certifikuar edhe sipas Rregullores së BE-së (dhe NOP të SHBA)	117 Operatorë
2	Kompanitë, që merren me bimë mjekësore e aromatike dhe gështenja nga grumbullimi i egër (mbledhës, konsolidues, përpunues dhe eksportues) të certifikuar prej Albinspekt në përputhje me Ligjin Shqiptar 106 / 2016 dhe sipas Rregullores së BE-së (dhe NOP të SHBA)	38 Operatorë nga të cilët 1 nuk është në kategorinë 1
3	Kompanitë e mëdha që eksportojnë bimë mjekësore dhe aromatike nga kultivimi dhe grumbullimi i egër të certifikuar nga organe të tjera kontrolli sipas Rregullores së BE-së (dhe NOP), por jo sipas ligjit shqiptar 106 / 2016	13 Operatorë
4	Përpunues të tjerë (prodhuesit e vajit të ullirit, përpunuesit e peshkut me vaj ulliri organik, prodhuesit e tekstilit organik)	9 Operatorë
GJITHESEJ		140 Operatorë

Figura 14: Katër kategoritë e operatorëve organikë ashtu si raportohen prej trupave të kontrollit

Prodhues të tjerë organikë kultivojnë perime, fruta, kultura speciale ose prodhojnë produkte blegtorale. Rezulton se një pjesë e madhe e fermerëve dhe pjesa më e madhe e grupeve të fermerëve që janë certifikuar gjatë Projektit SASA nuk e kanë vazhduar certifikimin e tyre edhe pse kryesisht nuk kanë ndryshuar sistemet e tyre të prodhimit. Aktualisht, tregu nuk i shpërblen përpjekjet për t'u certifikuar pasi nuk zbatohet mbrojtja e termit "bio". Shembuj të spikatur të prodhuesve të certifikuar janë ferma "7 Springs Bio", që prodhon mish dhe produkte qumështi pranë liqenit të Komanit, kantina e verës Kokomani pranë Durrësit dhe Tomadhea që prodhon kërpudha pranë Tiranës. Nga 19 kompanitë e përmendura në Tabelën 3–1 të Studimit të Sektorit të Bujqësisë Organike prej projektit SASA 2011, të cilat kanë furnizuar tregun vendas, vetëm 3 janë ende të certifikuara sot.

Faktorë të tjerë kufizues janë madhësia e vogël e fermave bujqësore me 90 % të fermave më të vogla se 2 ha. Duke pasur parasysh përvojën e kaluar të bashkëpunimit të detyruar, niveli i organizimit në mesin e

fermerëve të vegjël është jashtëzakonisht i ulët. Sot, fermerët zakonisht bashkëpunojnë vetëm brenda lidhjeve familjare. Problemet që lindin nga sistemet e rrënuara të ujitjes dhe kullimit po bëhen më të mprehta nga viti në vit. Një kufizim mjaft i ri është mungesa e fuqisë punëtore për shkak të emigrimit të fuqisë punëtore, e cila i detyron fermerët të investojnë dhe të mekanizojnë ose prodhojnë produkte me çmime jashtëzakonisht të larta. Shembujt e dhënë më sipër i ilustron mirë këto dy strategji.

Faktorët favorizues nga ana tjetër janë mbi të gjitha kapitali, njohuritë dhe përvoja që të kthyerit nga migrimi për motive punësimi sjellin në vendin e tyre. Pothuajse të gjitha bizneset e suksesshme në bujqësinë organike janë krijuar nga të kthyerit. Në përgjithësi, Shqipëria me shumëllojshmërinë e mikroklimave për shkak të lartësive të ndryshme bën të mundur prodhimin e një shumëllojshmërie të gjerë kulturash. Rrjeti rrugor për në luginat më të largëta është përgjithësisht i mirë. Inputet mund të vihen lehtësisht në dispozicion dhe tregu i Tiranës apo portet detare të Durrësit dhe Vlorës arrihen shpejt.



Figura 15: Konsulent I. Mehmeti me rigon organik të kultivuar



Figura 16: Autori me sherebelë të egër

Disa prodhues interesantë me një certifikate të vlefshme organike janë:

Elite AE

Elite AE (Z. Arben Islami), prodhuesi i parë organik i certifikuar në Shqipëri (prej 1999) me 1.2 ha sera plastike e ngritur në afërsi të Aeroportit të Tiranës me drejtim prodhimin e bimëve të freskëta për dërgesa javore në zinxhirët e shitjeve me pakicë si zvicëranë dhe gjermane (25 t eksporte në vit). Elite AE nuk është vetëm organike, por edhe e certifikuar nga GlobalGAP dhe SMETA. Bimët e kultivuara përfshijnë borzilokun, koriandrën, marjoranën, nenexhikun, rignonin, majdanozin, rozmarinën. trumzën dhe disa të tjera. Ato priten, lidhen në tufa të vogla dhe eksportohen me rrugë ajrore.

<https://www.facebook.com/ELITE-AE-5426277303/>

Mjalte Lunxheria

Mjaltë Lunxheria (Znj. Luljeta Dhima) nga Gjirokastra me 120 koshere bletë të certifikuara organike që prodhojnë të gjitha llojet e produkteve të bletës.

<https://www.facebook.com/mjaltelunxheria/>

Rea's

Rea's (Z. Eduard Bregu), prej 2002 një prej liderëve të tregut për vezët konvencionale, të vendosura midis Tiranës dhe Durrësit, kanë investuar në prodhimin organik të vezëve me më shumë se 10,000 pula në vitin 2019. Pularia (shtëpia e pulave) është ndërtuar me teknologjinë më të mirë gjermane te viteve të fundit. Pula ushqehet ne fushat e jonxhës. Vezët shiten në pako nga 5 në supermarketet Spar në Shqipëri me një çmim trefishin e çmimit të vezëve konvencionale që vijjnë nga pulari me mbarështrim në sistemet e kafazit.

<https://www.youtube.com/watch?v=7h-WTQMLkns>



Figura 17: Vezët Reas

Mrizi i Zanave



Mrizi i Zanave (Z. Altin Prenga), prej 2009 ka luajtur rol dhe shërben si model për agro-turizëm cilësor me një restorant fantastik me ushqim të ngadaltë midis Lezhës dhe Shkodrës. Ferma e vogël prodhon perime, fruta, rrush dhe ullinj dhe përpunon fruta dhe perime, si dhe qumësht dhe mish për restorantin e vet dhe dyqanet e specializuara ushqimore në Tiranë.

<https://www.mrizanave.al/>

